



Primitar / Doretuar Primihera/Prodato Received/Delivered	10-02-2023	3	viti god Year
Organ /Bjesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHCK	1678/2023		112



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.74/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca - kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në çështjen administrative sipas ankesës me numër A.nr.74/2023 të datës 17.01.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ nga _____ kundër Vendimit të datës 22.12.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me bazw juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar sipas nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 10.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës A.nr.74/2023 të datës 17.01.2023, të parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi _____ nëpunës civil në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 17.01.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 412/2023 nën shenjen A.nr.74/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës par Shërbimin Civil, kundër Vendimit të datës 22.12.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Ndërsa me datë 09.02.2023 i njëjti ka parashtruar kërkesë me numër protokoll 1646/2023 me të cilën ka tërhequr ankesën me numër A.nr.74/2023 të datës 17.01.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në nenin 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”, vendosi për përfundimin e procedimit administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.74/2023 të datës 17.01.2023, pasi që ankuesi _____ me datë 09.02.2023 ka parashtruar kërkesë me numër protokoll 1646/2023 me të cilën ka tërhequr ankesën me numër A.nr.74/2023 të datës 17.01.2023.



Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.74/2023

Avdyll BEKTESHI

Behteshi
Procesmbajtës



Jeton KOÇA

Jeton Koca
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

